



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet të mbledhjeve: 238, 241 dhe 243 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 239, 240, 242, 244 dhe 245 elektronike /korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafit 1. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për zbatimin e Procedurave Lëndore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Artikujve për Përdorim të Përbashkët, që janë Objekt i Procedurës Qendrore të Prokurimit Publik, e bashkëngjitur në Shtojcën e këtij Vendimi.
2. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjnë shpalljen e këtij vendimi, sipas nenit 95, paragrafit 2, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë

Tab. 1. Lista me artikujt për përdorim të përbashkët

Përshkrimi i artikullit	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja
1. Furnizim me letër për kopje;	Kontratë Kornizë	2 Vite
2. Furnizim me material zyrtar	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
3. Furnizim me vetura të udhëtarëve	Kontratë Kornizë	1 Vit
4. Furnizim me artikuj ushqimor	Kontratë Kornizë	1 Vit
5. Furnizim me mobile	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
6. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
7. Furnizim me pemë dhe perime (Marrëveshje kornizë)	Marrëveshje kornizë	3 Vite
8. Veturat me qira	Kontratë Publike Afatgjate	5 Vite
9. Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Kontratë Publike Afatgjate	3 Vite
10. Furnizim me karburante	Kontratë Kornizë	1 Vit
11. Furnizim me mazut	Kontratë Kornizë	2 Vite
12. Furnizim me ujë të pijes	Kontratë Kornizë	3 Vite



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Kombëtar për Zhvillim për vitet 2025-2027.
2. Pjesë e Planit nga pika 1. e këtij Vendimi janë:
 - 2.1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2025-2027;
 - 2.2. Plani i Dokumenteve Strategjike për vitin 2025; dhe
 - 2.3. Lista e Koncept-dokumenteve për vitin 2025.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e Planit Kombëtar, nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2025-2027 t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9, paragrafit 2. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për të përmbushur obligimet e pakryera financiare dhe kontraktuale nga viti paraprak.
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministrinë e ndikuara, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr./L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007, të nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 525,000€ (pesëqindnjëzetepesë mijë euro) për realizimin e projektit "Projekti për Teknologji të Numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit dhe Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale" nga projekti "Shpenzimet e Paparashikueshme 2019-2023" me kod 13255, dhe transferohen në "Komisionin Qendror të Zgjedhjeve", me kod 320, në nën-programin "Zgjedhjet" me kod 14200, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Projekti për Teknologji të Numërimit në Qendra Komunale të Numërimit dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve" me kod 19345.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Për
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 500,000€ (pesëqind mijë euro), për dhënie të përkrahjes për ndihmat humanitare në Gaza.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me kod 216, në nënprogramin "Administrata Qendrore" me kod 11316, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49, paragrafit 1. dhe 2. të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, nenit 16 të Rregullores Nr. 15/ 2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arton Ahmeti, emërohet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, Segmenti Dollc-Ramun, Zonat Kadastrale: Dollc, Zajm, Grabanicë, Drenoc, Pjetërq i Epërm dhe Pjetërq i Poshtëm, Komuna Klinë dhe Zonat Kadastrale: Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Gllaviçicë dhe Ramun, Komuna e Pejës sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislaionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N2 Segmenti "Hyrja në Qytetin e Ferizajt", Zonat Kadastrale: Prelez i Jerlive, Muhoc, Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve, Ferizaj dhe Fshat i Vjetër, Komuna Ferizaj, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R-118 Mushtisht-Shtërpçë, Zonat Kadastrale: Delloc, Komuna Suharekë dhe Vërbeshticë, Komuna Shtërpçë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25, Segmenti QMI-Lipjan, Zona Kadastrale: Suhadoll, Livagjë, Komuna e Graçanicës dhe Zonat Kadastrale: Konjuh dhe Lipjan, Komuna e Lipjanit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 46, paragrafit 9. të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesë të dyqindnjëzetekatër (224) Specializantëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere" në nën-programin "Aftësim Specialistik" dhe EVM me kod 90300, në vlerë 2,365,440.00€ (dy milion e treqindegjashtëdhjetepesë mijë e katërqindedyzet euro) prej datës 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2025.
2. Obligohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet e tjera kompetente, t'i kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 36, paragrafit 4, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Shkollim Specialistik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesë të tridhjetë (30) Specializantëve me vetëfinancim nga Lujina e Preshevës, Mali i Zi etj., nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere", nën-programin "Aftësimin Specialistik" dhe EVM kod 90300, në vlerë 316,800.00€ (treqindegjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind euro) prej datës 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025.
2. Obligohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet e tjera kompetente, t'i kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mbrojtjes për dhënien në shfrytëzim të pronave të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me sipërfaqe prej 100000m² (100ha) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2120465m² të pronës/lokacionit në Batllavë, e evidentuar sipas Certifikatës pronësore P-71712006-00300-0 (vendi i quajtur Lumi i Surdullit dhe e evidentuar si pronë shoqërore - Ndërmarrja e Pyjeve), e skicuar sipas Raportit të pranimit të shënimeve nga AKK-ja, të datës 19 prill 2024.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e shtatëmbëdhjetë (17) vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
 - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesuese;
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes, anëtar;
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, anëtar;
 - Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, anëtar dhe
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
- Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - Zyra e Presidentes, anëtar;
 - Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - Organizatata e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar; dhe
 - Përfaqësues të OJQ-ve.
- Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

për 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 62 paragrafit 4. të Ligjit N.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063, dhe me Ligjin Nr.05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Prishtinës për aprovimin e Buxhetit pas miratimit të Buxhetit për vitin 2025 nga Kuvendi Komunal.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimi së bashku me tabelat t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komuna e Prishtinës, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit N.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007, nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000€ (pesë mijë euro), për realizimin e projektit "Shtëpia Nr.10 në Qytetin e Vjetër në Janjevë, Lipjan".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga "Shpenzimet e Parashikuara" me kod 232, nga nën-programi "Shpenzimet e Parashikuara" me kod 13100, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale" nga projekti "Shpenzimet e Parashikueshme 2019-2023" me kod 13225, dhe transferohen në "Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit", me kod 207, në nën-programin "Mbrojtja Rruajtja e Trashëgimisë Kulturore" me kod 81500, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" në projektin "Shtëpia Nr. 10 në Qytetin e Vjetër në Janjevë, Lipjan", me kod 19478.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Pasqyra Preliminare Financiare për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Pasqyrën nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 9. të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad-hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Inspektoratin Qendror të Punës, në këtë përbërje:
 - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, kryesuese;
 - Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë, anëtare;
 - Kaltrina Dauti-Bytyqi, U. D. Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerëzore në MFPT, anëtare; dhe
 - Valon Avdiu, Ekspert i jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e tij, në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/247
Datë: 31.01.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad-hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë përbërje:
 - Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, kryesues;
 - Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës, anëtar;
 - Arta Nuredini, Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore, anëtare;
 - Besart Belegu, Ekspert i jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e tij, në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë